



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 222/ Prot.

Tiranë, më 01/02/2022

**Lënda:** Njoftim dhe kërkesë për informacion.

**Televizionit Vizion Plus  
Emisioni "Spot Light"  
Rruga Don Bosko, Nr.5**

**Z. Arben MEÇE  
Opinionist  
Rruga Don Bosko, Nr.5**

**Tiranë**

**Për dijëni: Z. Denis KOSTURI  
Përfaqësues i Rrjetit të Organizatave R/E, Korçë  
Rruga "Pandi Raidhi", Lagjia 4, Nr. 45,  
Përfaqësues i Rrjetit të Organizatave R/E**

**Korçë**

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 21, datë 01.02.2022, e Rrjetit të Organizatave R/E, Korçë, ku pretendohet diskriminim në formën e gjuhës së urrejtjes, për shkak të "racës", të pakicës kombëtare rome, nga ana e opinionistit Arben Meçe, në Emisionin "Spot LIGHT", të moderuar nga z. Alban Dudushi, në Televizionin Vizion Plus, si dhe nga ana e Televizionit Vizion Plus.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, rezulton se në datën 21.01.2022, në Emisionin "Spot LIGHT", të moderuar nga z. Alban Dudushi, në Televizionin Vizion Plus, gjatë diskutimeve të zhvilluara në studio, në minutën 75 opinionisti Arben Meçe ka përdorur shprehjen "si arrixinjtë në rrugë me trastën në kurriz" duke iu referuar grupimit të veçantë të një subjekti të caktuar politik. Subjekti ankues pretendon se shprehja e përdorur nga opinionisti Meçe është mbështetur nga kolegët pjesëmarrës në diskutim, sikurse dhe nga redaksia e emisionit, e cila nuk ka reaguar, por përkundrazi e ka mbështetur duke i vënë titullin "Spotlight - Shpërthen Meçe: Grupi i

*Berishës, si arrixhinjtë në rrugë! - 21 Janar 2022 - Vizion Plus*”, lajmit të hedhur në linkun <https://www.youtube.com/watch?v=25KWclSRia8>.

Për sa më sipër, rrjeti i Organizatave R/E në qytetin e Korçës shprehin indinjatën e thellë për këtë shprehje të përdorur nga opinionisti Arben Meçe, pasi dëmton imazhin e komunitetit rom dhe e diskriminon hapur këtë pakicë kombëtare. Subjekti ankues pretendon se opinionisti ka përdorur gjuhë urrejtje ndaj kësaj pakice kombëtare dhe kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit, në formën e gjuhës së urrejtjes, për shkak të racës, të komunitetit rom.

Referuar nenit 32, pika 1, gërma a), nenit 32, pika 2 dhe nenit 33, pika 7, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, duke pasur nën vëmendje që veprime të tilla, mund të përbëjnë objekt të këtij ligji, Komisioneri kërkon informacion me shkrim, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijëni mbi këtë shkresë, mbi çështjen e parashtruar nga subjekti ankues.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

